

ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT

Sipas Nenit 109 të Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092

Një ankesë kundër: **MIN.E BUJQËSISË, PYLLTARISË DHE ZHVILL. RURAL**

Për Aktivitetin e Prokurimit Nr. i AP: **203-24-8259-5-2-1**

Sa i përket tenderit për: **Rrënimi i objekteve ku do të ndërtohet objekti i MBPZHR-së**

A N K E S Ë

1. Identifikimi i ankuesit*

_____ **OE "TempO-2 SH.P.K."** _____
(Shëno emrin e plotë të kompanisë suaj)

_____ **Mramor, Prishtinë** _____
(Adresa)

_____ **Prishtine** _____ **10000** _____
(Vendi) (Kodi postar)

_____ **+383 45710708** _____
(Numri Telefonit) (Numri i Faks-it)

_____ **Arnit Gashi** _____
(Emri i plotë i përfaqësuesit të kompanisë suaj)

_____ **tempotrans01@gmail.com** _____
(Adresa elektronike)

_____ **16.10.2025** _____
(Data e parashtrimt të ankesës)



_____ (Nënshkrimi dhe vula)

*Ankues do të thotë një palë e interesuar për parashtrim të ankesës.

2. Identifikimi i avokatit

Parashtruesi i ankesës mund ta parashtroj ankesën vetëm ose përmes avokatit të tij. Nëse ankesa parashtrohet përmes avokatit, atëherë duhet bashkangjitur autorizimin e përfaqësimit me PROKURË.

Shëno të dhënat si në vijim:

(Emri i avokatit)

(Adresa e plotë)

(Numri i Telefonit)

(Numri i faks-it)

(Adresa elektronike)

(Data e parashtrimt të ankesës)

(Nënshkrimi dhe vula)

3. Të dhënat mbi aktivitetin e prokurimit

[Shëno një përshkrim të shkurtër lidhur me datën dhe vendin në të cilën është publikuar “Njoftimi për Kontratë” apo “Njoftimi për konkurs të projektimit” dhe, nëse aplikohet “Njoftimi për dhënie të Kontratës”, “Njoftimi për Rezultatet e Konkursit të Projektimit” apo “Njoftimi për anulim të aktivitetit të prokurimit”, nëse aplikohet, afatin e fundit për dorëzimin e tenderit, datën dhe orën e fillimit të procesit për Hapjen e Tenderëve, si dhe kriteri për dhënie të kontratës].

Njoftimi për Kontratë - 14.08.2024,
Formulari për korrigjimin e gabimeve - e fundit është publikuar me date 29.09.2025,
Hapja publike nuk është bërë por është caktuar për - 08.10.2025,
Kërkesa për Rishqyrtim u dorëzuar me datë 02.10.2025,
Vendimi për refuzim është publikuar me datë 06.10.2025,
Pas refuzimit të Kërkesës për Rishqyrtim, hapja publike nuk është bërë por është ricaktuar për - 17.10.2025,
Të pakënaqur me vendimin e AK-së për refuzimin e Kërkesës për Rishqyrtim, po i drejtohem OSHP-së me këtë ankesë.
Kriteri i vlerësimit - Tenderi i përgjegjshëm me çmim më të ulët.

4. Procesi i Hapjes së tenderëve, nëse aplikohet

A keni marrë pjesë në procesin e Hapjes së tenderëve? Nëse po, specifikoni shkurtimisht ecurinë e procesit të Hapjes së Tenderëve.

Po ☐

Jo ☒

Hapja e tenderëve është e ri caktuar për datën 17.10.2025.

5. Njoftimi mbi Eliminimin e Tenderuesve, nëse aplikohet

A jeni njoftuar me shkrim lidhur me eliminimin tuaj nga pjesëmarrja e mëtutjeshme në aktivitetin e prokurimit ?

Po ☐ N/A

Jo ☐ N/A

6. Zgjidhja preliminare e mosmarrëveshjeve

A keni bërë kërkesë për rishqyrtim pranë AK lidhur me arsyet e eliminimit tuaj?

Po ☒ X

Jo ☐

Afati për dorëzimin e tenderëve është ri caktuar të bëhet më datën 17.10.2025.

Të pakënaqur me kriteret dhe kërkesat e dosjes së tenderit, me datë 02.10.2025 kemi parashtruar Kërkesë për Rishqyrtim tek AK.

Me që AK në datën 06.10.2025 ka refuzuar pretendimet tona të parashtruara në Kërkesë për Rishqyrtim, në përputhje me ligjin po i drejtohem OSHP-së me këtë ankesë.

7. Dispozitat e shkelura nga Autoriteti Kontraktues

Specifikoni dispozitën ose dispozitat e LPP-së që supozohet të jenë shkelur nga Autoriteti Kontraktues që nga momenti i publikimit të Njoftimit për Kontratë/Konkurs të Projektimit, dhe nëse aplikohet gjerë në përmbylljen e këtij aktiviteti të prokurimit me publikimin e Njoftimit për Dhënien e Kontratës apo Njoftimit për Rezultatet e Konkursit të Projektimit apo Njoftimit për Anulim.

1. Barazia në Trajtim/ Jo- Diskriminimi - **Neni 7 të LPP-së**

2. Dosja e Tenderit - **Neni 27 të LPP-së**

3. Dosja e Tenderit - **Neni 17 të RRPP-001/2022**

4. Specifikimet teknike – **Neni 28 i LPP-së**

*** Sipas Nenit 118 të LPP, OSHP-ja do të kthej tarifën tuaj nëse ankesa aprovohet si e bazuar. OSHP-ja mund të kërkojë një gjobë shtesë deri në 5,000 Euro në rastet kur OSHP-ja konstaton që të gjitha apo cilado nga pretendimet e parashtruara në ankesë kanë qenë të rrejshme ose mashtruese.*

8. Deklaratë detale mbi faktet dhe argumentet

Përshkruani rrethanat faktike që përbëjnë supozimin për shkeljen e dispozitave të LPP-së. Ofroni deklaratë të qartë dhe të detajuar për faktet dhe argumentet të cilat mbështesin secilën bazë të ankesës tuaj.

AK ka shkelur nenin 7 të LPP-së - AK ka shkelur dhe vazhdon ta shkelë këtë dispozitë me që gjatë hartimit të dosjes së tenderit dhe Aneksit 1 ka vendosur kritere kufizuese të cilat qartë shihet se i diskriminojnë numër të caktuar të OE. Ky veprim është i ndaluar dhe në kundërshtim të plotë me nenin 7 të LPP-së si dhe me nenin 27 dhe 28 të LPP-së por edhe me nenin 17 të RRPP-001/2022. Këto nene qartë flasin për obligimin e AK-së në mos diskriminimin e OE, për informata të sakta rreth punimeve si dhe flasin edhe për hartimin profesional të dosjes së tenderit të cilat AK i ka shkelur të gjitha.

Krejt kjo konsiderohet favorizim i OE të caktuar dhe diskriminim i OE të tjerë e që si veprim është në kundërshtim të plotë me nenin 7 të LPP-së.

Kriteret kufizuese më detalisht do ti përshkruajmë tek shkeljet tjera që lidhen drejt për drejt edhe me nenet e LPP-së dhe RRPP-së që mendojmë se AK i ka se janë shkelur.

AK ka shkelur nenin 27 të LPP-së dhe nenin 17 të RRPP-001/2022 - pasi që gjatë hartimit të dosjes dhe të kërkesave për mundësitë teknike dhe/ose profesionale ka vendosur kritere kufizuese. Bazuar në këtë del që dosja e tenderit nuk është hartuar në përputhje me nenin 27 të LPP dhe nenin 17 të RRPP-001/2022. Ja si e përshkruan detyrimin e AK-së në hartim të dokumenteve të tilla neni 17 i RRPP-001/2022:

17.17 Dosja e tenderit do të përgatitet në mënyrë që nuk:

- a. Kufizon konkurrencën në mesin e OE, ose
- b. Diskriminon kundër ose vepron në favor të një ose më shumë OE.

AK nuk e ka respektuar fare këtë rekomandim andaj theksojmë se gjatë ri hartimit disa herë të dosjes së tenderit, janë shkelur parimet bazë të prokurimit, neni 27 i LPP-së si dhe neni 17 i RRPP-001/2022. Detajet e shkeljeve i gjeni në vazhdim:

Në dosjen e tenderit për projektin në fjalë janë vendosur disa kërkesa të cilat duken qartë se nuk janë në përputhje me LPP dhe RRPP-001/2022 për natyrën e projektit, janë kërkesa të paqarta që lënë vend për manipulim gjatë procesit të vlerësimit e sidomos gjatë implementimit si dhe nuk janë aspak proporcionale me madhësinë dhe volumnin e projektit. Në vazhdim po i renditim të gjitha pretendimet tona rreth kritereve kufizuese dhe jo proporcionale.

Kufizimi i konkurrencës - AK gjatë hartimit të dosjes së tenderit ka lënë paqartësi të madhe tek sasia e punimeve që do kryhen e sidomos tek **Specifikimi Teknik** përkatësisht tek **Lista e Çmimeve** pasi që nuk ka përcaktuar as për së afërmi sasinë e punëve apo materialeve që do trajtohen. Kjo do të krijoj shumë probleme në përcaktim të kostos ofertuese e sidomos do të krijoj probleme gjatë implementimit të projektit. **Problemet që do të paraqiten gjatë implementimit janë ato që realisht objektet e tilla do të largohen**

nga vet pronarët e deritanishëm të tyre dhe AK do të paguaj para hupëse OE të përzgjedhur. Këtë e kemi kuptuar pas vizitës në terren dhe komunikimin me pronarët e objekteve që AK mendon të i largoj. Pra secili nga shfrytëzuesit e deritanishëm të asaj prone do të largoj vet objektin e tijë për qëllim të përdorimit në një vend tjetër pasi në shumicën e rasteve objektet e tilla janë montazhë/të lëvizshme ndërsa AK po tenton të shpenzoj para humbëse duke i favorizuar OE të caktuar. Sipas kësaj vijnë në konkluzion se AK e din këtë shumë mirë këtë informatë ku sipas disa të dhënave thuhet se edhe i ka të evidentuara saktë këto informata, të cilat tashmë ia ka dhënë OE-së të preferuar që parashikojnë të ja japin këtë kontratë.

Pikërisht kjo është edhe arsyeja se pse AK e ka vendosur tërë punën e nevojshme në 4 pozicione dhe kjo është arsyeja pse pothuajse e tërë sasia e punës është përcaktuar të jetë paushall (*komplet apo kuturu*).

Nisur nga kjo ne e shohim veprimin e tillë të AK-së dhe mos përcaktimin e saktë të sasisë së punës si një favorizim të hapur për një ose dy OE të cilët kushtimisht veç dihet se kush do jenë.

Vlen të tregohet edhe kjo se gjatë vizitës në terren, pas matjeve paraprake, kemi vërejtur një mospërputhje të madhe mes sasive të saktësuar nga autoriteti kontraktuese dhe situatës reale në terren. Për parcelën në fjalë në projekte të tilla zakonisht preferohet të ketë një përshkrim të detajuar të të gjitha sistemeve të ujësjellësit, rrjetit elektrik, rrjetit tjetër nëntokësor bashkë me objekte që ndodhen në sipërfaqe pasi të gjitha punimet që kërkohet të kryhen në atë zonë kanë rrezikshmëri të lartë dhe mund të ketë ndonjë shpërthim të papritur nëse këto informata nuk janë të qarta dhe të bashkangjitura në formë të skicave të sakta dhe të detajuara. Edhe projekti ideor i paraqitur në faqe nuk është as për së afërmi i saktë në raport me gjendjen reale që mbretëron në ato hapësira.

Për rrjetin elektrik do duhej të ishte po ashtu një përshkrim i të detajuar, pasi shumica e asaj zone furnizohet nga ai rrjet i energjisë elektrike dhe mund të ketë detaje të pakontrolluara të cilat mund të shkaktojnë probleme serioze dhe mosrealizim të kontratës si duhet. Edhe pse AK ka dhënë një lloj sqarimi, prap të dhënat e tilla nuk janë të mjaftueshme për të kuptuar sasinë e punës që të kemi mundësi të përcaktojmë një çmim real për koston e largimit dhe trajtimit të tyre e sidomos kur marrim parasysh informatën e fundit që shumica nga poseduesit e deritanishëm të objekteve do të i largojnë vet ato në mënyrë të kontrolluar.

Gjithashtu, i gjithë rrjeti i ujësjellësit dhe kanalizimeve për komunitetin përreth është i lidhur me këtë pjesë ku sipas paramasës, duhet të bëhet zhvendosja e tijë. Bazuar në këtë, kërkojmë nga OSHP që ta detyroj AK-në për të siguruar një plan të detajuar për zhvendosjen dhe llojet e punimeve që do të kryhen këtu, pasi kemi shumë paqartësi në paramasë për çka edhe mund të lindin keqkuptime dhe keqpërdorime të mëdha gjatë zbatimit.

Edhe objektet që ndodhen në këtë zonë, siç janë pompat e derivateve, kanë rrezikshmëri të lartë dhe kërkohet të ketë një përshkrim detal të rrjetit nëntokësor të tyre për zhvendosjen e rezervuarëve ose pajisjeve të ndryshme që janë shumë të rrezikshme dhe mund të shkaktojnë dëme të mëdha dhe të paparashikueshme. Informacioni që gjoja OE do duhet të kryejnë punime deri në **50cm** thellësi është gabim pasi që aty sipas asaj që ne kemi parë, ka vende ku elementet që duhet rrënuar dhe larguar janë deri në 20m nën sipërfaqen e tokës. Tash si të përcaktohet kosto kur AK kërkon punime deri në 50cm thellësi, ndërsa aty ka objekte në thellësi deri afro 20m nga niveli i rrugës që kalon andej dhe kur qarkullojnë informatat se objektet e tilla do të largohen nga vet poseduesit e jo kontraktorët. Këtu shtrohet pyetja se a

duhet të largohen materialet që ndodhen më thellë se sa një Bodrum pasi që AK ka thënë që punimet bëhen diku në (B+P+2) ku zakonisht lartësia bodrumit apo etazheve është 2.0-2.5 metër e diku ka konstatua se do punohet vetëm deri në thellësinë 50cm, apo duhet larguar edhe ato që janë deri në 20 metra thellësi? Kjo thellësi e materialeve dhe objekteve vjen për shkak të disnivelet të zonës gjë të cilën AK nuk e ka paraqitur askund andaj është vështirë të përcaktohet me këto të dhëna vlera reale e koston së projektit për një OE. Ja si duket pozicioni 1.2 për këto demolime dhe largime që lënë hapësirë të madhe për manipulim:

Demolimi i kontrolluar dhe largimi I materialit deri ne deponin sanitare (ose deponi ricikluese) - deponimi dhe largimi I te gjitha strukturave solide (asfaltt me nenshtresa; Beton siperfaqesor me nenshtresa; objekte nga metali, objekte nga guri dhe te gjitha materialet solide egzistuese siperfsqesore duke i llogaritur ne thellsi max. 50cm. Paraprakisht para ofertimit per kete pozicion te behet vizita ne teren.

Paramendo, tërë demolimin, demontimin dhe largimin në formë të kontrolluar të infrastrukturës dhe objekteve në një hapësirë aç të madhe e ka vendosur vetëm në katër pozicione për çka do jetë e pamundur që të ofrohet një çmim i saktë i koston së punës së tillë. Për tërë ato punime që realisht duhet të bëhen, është dashur që ato të shpërndahen së paku në 30 pozicione veç e veç sepse vetëm ashtu AK do bënte realizim të mirëfilltë të projektit dhe shpenzim ekonomik të mjeteve të parashikuara për këtë qëllim.

Ne kemi informacione se AK qëllimisht prap po i fshehë informata e tilla për publikun ndërsa disa nga OE-ve tani më veç u janë shpërndarë shënime të sakta për volumin e punimeve që do kryhen pasi që një pjesë e madhe e tyre do të kryhen nga vet pronarët e objekteve. Kjo është e ndaluar prandaj kërkojmë nga OSHP që ta detyroj AK-në që specifikimi teknik bashkë me projektin të e bëjnë të saktë dhe real.

Edhe shënimi që gjoja bashkë me dosje do jepet edhe projekti detal është vetëm si informatë në letër sepse askund nuk ka ndonjë projekt detal të bashkangjitur në dosjen e tenderit. Projekti i tillë i publikuar është skicë që ma së paku mund të quhet projekt.

Sipas kësaj të gjitha përshkrimet e punimeve që do kryhen janë të hartuara jo mirë, posedojnë kufizime dhe favorizime, lënë vend për keqkuptime dhe keqpërdorime si kriteret, të cilat në të njëjtën kohë bien ndesh edhe me kërkesat e nenit 28 të LPP-së. Nisur nga kjo, ne mund të themi se AK ka shkelur nenin 27 të LPP-së si dhe 17 të RRPP-001/2022 dhe ndryshimi i shumëfishtë i dosjes së tenderit është vetëm arsyetim që gjoja ne po duam ta bëjmë dosjen mirë dhe sipas ligjit. Në fakt, secilën herë që është ndryshuar dosja e tenderit, vetëm sa është komplikuar më shumë.

Bazuar në krejt këtë që e thamë më lartë, kërkojmë nga OSHP që ta anuloj komplet procedurën e prokurimit, dhe ta detyroj AK-në që të angazhohet seriozisht në hartim të një projekti detal të punimeve dhe të ri filloj me një procedurë të re sepse ky projekt në këtë formë tashmë e ka humb kuptimin me ndryshime të shumëfishta që janë bërë deri më tani.

Mbështetur në këtë, kërkojmë gjithashtu nga OSHP që ta detyroj AK-në për rregullimin e kriterëve në fjalë duke i përshtat ato me praktikën e mira të prokurimit si dhe të vendosen vetëm kërkesa proporcionale me projektin dhe natyrën e tij.

AK ka shkelur nenin 28 të LPP-së me rastin e përcaktimit të specifikimeve teknike pasi që ka nuk ka ofruar të dhëna të sakta tek përshkrimi i punëve që do realizohen me kontratën në

fjalë. Sqarimet se në cilat pika është shkelur neni në fjalë janë dhënë tek pretendimi 1 dhe 2 andaj kërkojmë që ato kërkesa të përmirësohen dhe të sillen brenda normave ligjore të përcaktuar me ligj. Në bazë të kësaj lehtë konstatohet se AK nuk ka vepruar në përputhje me nenin 28 të LPP dhe si rrjedhojë gjatë hartimit të dosjes së tenderit edhe e ka shkelur ligjin dhe nenin në fjalë.

Bazuar në kërjt këtë që theksuam më lart kërkojmë nga OSHP që të merr:

V E N D I M

APROVOHET si e bazuar ankesa e OE “TempO-2 SH.P.K.” lidhur me tenderin “**Rrënimi i objekteve ku do të ndërtohet objekti i MBPZHR-së**”.

ANULOHET njoftimi për kontratë i AK - **MIN.E BUJQËSISË, PYLLTARISË DHE ZHVILL. RURAL.**

Të detyrohet AK që të anulohet komplet procedurën sepse u ngatërrua aq shumë sa që s’ka mundur më të shkohet duke u modifikuar prandaj gjatë ri tenderimit duhet të angazhohet seriozisht që të eliminoj gabimet e lëna tek specifikimi teknik i punëve. Gjithashtu të rishikohen të gjitha kërkesat e dosjes së tenderit duke i harmonizuar ato me LPP-në dhe RRPP-001/2022 si dhe duke ia përshtatur natyrës së projektit, procedurës si dhe shpenzimit efikas dhe efektiv të parasë publike dhe masave reale të terrenit.

9. Dëmet materiale

Përshekruaj mënyrën se si shkelja e supozuar i ka shkaktuar ose kërcënohet t’i shkaktojë dëme materiale parashtruesit të ankesës, ne rast se përfshini pretendime për kompensim.

Fitime të munguara dhe shpenzimet përgatitore për tenderim.

10. Lista e dokumenteve (dëshmime) të bashkangjitura

Nëse aplikohet, bashkëngjitni Ankesës dokumentet e renditura më poshtë:

- 1. Njoftimi për kontratë,**
- 2. Dosja e tenderit – e korrigjuar,**
- 3. Paramasa,**
- 4. Formulari standard për korrigjimin e gabimeve ne njoftimet e publikuara 29.09**
- 5. Kërkesa për rishqyrtim e datës 02.10.2025,**
- 6. Vendimi mbi refuzimin e Kërkesës për Rishqyrtim i datë 31.07.2025**
- 7. Formulari standard për korrigjimin e gabimeve ne njoftimet e publikuara 07.10.2025**

****Sipas Nenit 111.2 të LPP, Parashtruesi i ankesës, origjinalin e ankesës do t’ia dorëzojë OSHP-së dhe njëkohësisht një kopje do t’ia dërgojë në mënyrën më të shpejtë të mundshme Autoritetit Kontraktues.*